



Prishtinë, 29.07.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1562_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2309_05_22** i dt.16.05.2022;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **01.06.2022**;

në seancën e mbajtur më datë 29.07.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin G. R., nga komuna e Gjakovës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRrE/DMK_V_2309_05_22, i datës 16.05.2022.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 16.05.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2309_05_22 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit G. R., dhe ka obliguar KESCO-n që të anulojë korrigjimet nr.27368DGJ-11162 dhe nr.27369DGJ-11162 datë 05.10.2021.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Korrigjimi i datës 05.10.2021 është në përputhshmëri të plotë me rregullat në fuqi, pasi që nëse energjia e shpenzuar nga konsumatori nuk është regjistruar e tëra në njehsorin elektrik, por vetëm një pjesë e saj si pasojë e djegies, atëherë pjesa e mbetur e energjisë së shpenzuar por e pa regjistruar në njehsor përmirësohet përmes korrigjimit të faturave për 6 muajt e fundit të faturimit.
- ZRrE/DMK arsyetimin e saj e mbështet në shpenzimin e energjisë elektrike me njehsorin paraprak dhe me njehsorin aktual, ku konstaton se me njehsorin paraprak nr.9002004, për periudhën 02/2021 deri 11.06.2021 shpenzimi është i përafërt me shpenzimin për periudhën dy javore 11.06.2021 – 25.06.2021 me njehsorin aktual nr.78471651 ku shpenzimi për këtë periudhë ka qenë 174 kWh që dmth është i përafërt me periudhën kontestuese 02/2016 deri 11.06.2021.
- Konsumatori nuk ka prezantuar dëshmi për qiramarrje të objektit dhe në bazë të deklaratës noteriale siç është bazuar ZRrE/DMK konsumatori ka qenë me qera për periudhën janar 2021



deri qershor 2021 dhe bazuar në këtë fakt përderisa për këtë periudhë objekti ka qenë me qera atëherë edhe shpenzimi është bërë, mirëpo për shkak të djegies së njehsorit nuk është bërë matja e saktë e shpenzimit.

- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2309_05_22 i datës 16.05.2022 për konsumatorin G. R.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se korrigjimi i datës 05.10.2021 është i saktë, ZRrE thekson se, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, si Ankesa e konsumatori në KESCO, Vendimi i KESCO-s, Transaksionet e konsumatorit, Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0848500 datë 11.06.2021, Procesverbali i kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 9755 datë 29.09.2021,

Korrigjimet nr.27368DGJ-11162 dhe nr.27369DGJ-11162 datë 05.10.2021, Faturat e energjisë elektrike, Ankesa e konsumatorit në DMK dhe Rrjedhën e energjisë elektrike aktive, ka gjetur se, ky pretendim nuk qëndron si i tillë, sepse, nga të gjitha provat e përmendura si më lartë si dhe sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese si dhe më të hershme me njehsorin e vjetër elektrik nr. 9002004 dhe njehsorin e ri elektrik nr. 78471651 për periudha të njëjta kohore, konstatohet se ka ndryshim të shpenzimeve, ka rritje të shpenzimit pas ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 9002004 si dhe ndryshim krahasuar me shpenzimet e më hershme për periudha të njëjta me njehsorin kontestues.

Në një vështrim kronologjik të këtij rasti, ZRrE gjen se, fillimisht punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 9002004 me gjendje TL=10992 kWh dhe TU=45639 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 78471651 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipet e KEDS-it kanë evidentuar se ndërrimi i njehsorit bëhet me kërkesë të konsumatorit dhe se njehsori i vjetër është i djegur. Më pas, punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 9002004 me gjendje të shpenzimeve TL=10992 kWh dhe TU=45639 kWh ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik bllobat(vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori pjesën kyçëse e ka të dëmtuar nga djegia. Në brendi të njehsorit komisioni nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi. Në zhvillim të rastit, Departamenti i faturimit në KESCO përmes korrigjimeve nr.27368DGJ-11162 dhe nr.27369DGJ-11162 e ka ngarkuar konsumatorin në vlerë financiare **293.17€** duke bërë korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 02/2021 deri në periudhën 06/2021 (17 dite). I pakënaqur, konsumatori parashton ankesë në KESCO, mirëpo e njëjta refuzohet, andaj konsumatori parashton ankesë në DMK të ZrE-së. Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik si dhe njehsorin e ri elektrik konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore dhe se në asnjë rast nuk lexuesi nuk ka evidentuar që njehsori elektrik është i dëmtuar në çfarëdo forme përveç se në disa periudha ka evidentuar se nuk ka qasje në leximin e pikës matëse-dhe keqpërdorim i energjisë elektrike kurse në periudhën 02/2021 ka evidentuar se njehsori është i shkyçur.



Bordi ka shqyrtuar korrigjimin plotësues të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar bazuar në procedurat dhe kodet në fuqi sipas së cilave në rastet kur konstatohet se ka defekt në sistemin matës atëherë duhet të bëhen të gjitha korrigjimet e nevojshme duke bërë ri llogaritjen e energjisë përkatësisht përmirësimi i faturimit e që për konsumatorët komercial përfshin periudhën një vjeçare kurse konsumatorët shtëpiak periudhën gjashtë mujore, sipas nenit 4.11 të Kodit të Matjes i Energjisë Elektrike të OSSh-së, por që në rastin e konsumatorit duke pasur parasysh edhe listat e leximit, listën 02/2021 ku është evidentuar se konsumatori është i shkyçur dhe se nuk është evidentuar asnjë vërejtje mbi dëmtimin e jashtëm të njehsorit si dhe duke pasur parasysh shpenzimin e ulët me njehsorin nr. 78471651 për periudhën 11.06.2021 deri me 25.06.2021 konstaton se konsumatorit nuk është dashur t'i bëhet një korrigjim plotësues.

Bordi, pas analizimit të rrjedhës së energjisë elektrike gjeti se mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr. 9002004 për periudhën 02/2018 deri në periudhën 05/2018 është **952 kWh/muaj**, periudhën 02/2019 deri në periudhën 05/2019 është **1,216 kWh/muaj**, periudhën 02/2020 deri në periudhën 05/2020 është **1,832 kWh/muaj**, si dhe periudhën kontestuese 02/2021 deri në periudhën 05/2021 është **132 kWh/muaj** kurse me njehsorin e ri elektrik nr. 78471651 periudha 02/2022 deri në periudhën 04/2022 është **3,714 kWh/muaj**. Bordi vëren se në periudhën 06/2021 (dy javore) me njehsorin e ri konsumatori është faturuar me **174 kWh** (periudha 11.06.2021 deri me 25.06.2021) e që krahasuar me periudhat e njëjta të më hershme ka dallim në faturim. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike shpenzimi me njehsorin elektrik nr. 9002004 për periudhën: 06/2020 është **899 kWh/muaj**, periudhën 06/2019 është **1,028 kWh/muaj**, periudhën 06/2018 është **921 kWh/muaj** dhe periudhën 06/2017 është **1,039 kWh/muaj**.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në kundërshtim nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit G. R., dhe
- Arkivit të ZRRE-së